



SHËRBIMET E KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR NË LIPJAN

&

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E QYTETARËVE NË KUJDESIN SHËNDETËSOR



KOMUNA E LIPJANIT



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministertvo Zdravstva - Ministry of Health



Accessible
Quality
Healthcare

Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor
Kvalitetna i Dostupna Zdravstvena Zabrta

SDC project implemented by Swiss TPH and Save the Children

PËRKUFIZIMET



ÇKA ËSHTË SHËNDETI?

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh), shëndeti është:

“Gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo thjesht mungesa e sëmundjeve apo e pafuqisë fizike të organizmit.”

ÇKA ËSHTË KUJDESI SHËNDETËSOR DHE E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR?

Kujdesi shëndetësor është tërësia e masave dhe veprimeve që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësorë, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve

Çdo qytetar ka të drejtë për kujdes shëndetësor që kushtëzohet nga gjendja e tij/saj shëndetësore. Kujdesi shëndetësor duhet të jetë adekuat, dhe vazhdimisht i qasshëm, për të gjithë dhe pa diskriminim.

ÇKA ËSHTË KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR (KPSH) DHE ÇKA OFRON?

- **Porta e parë hyrëse në sistemin shëndetësor të Kosovës**, e cila shërben si pikë koordinuese për të gjitha shërbimet tjera shëndetësore, sipas nevojës.

- Ofron promovimin dhe edukimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm / diagnostikimin, mjekimin / kujdesin dhe rehabilitimin e të lënduarit, të sëmurit me sëmundje akute dhe kronike, si dhe kujdesin e vazhdueshë për sëmundje të rënda në fazën terminale (kujdesi paliativ), të ofruara në institucione të KPSH dhe në komunitet, gjegjësisht në shtëpi.

KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR NË KOMUNËN E LIPJANIT

ËSHTË I ORGANIZUAR NË KËTO INSTITUCIONE:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare është një institucion shëndetësor që organizon shërbime shëndetësore në kuadër të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Lipjan.

Qendra e Mjekësisë Familjare funksionon në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ofron shërbime shëndetësore për vendbanimet që kanë mbi 5,000 banorë.

Ambulantat e Mjekësisë Familjare ofrojnë shërbime shëndetësore në zonat rurale të Lipjanit dhe menaxhohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare.

Këto janë kategoritë e liruar nga pagesa në Institucione Shëndetësore:

- Imunizimi
- Shtatzënia dhe planifikimi i familjes
- Fëmijët parashkollorë
- Nxënësit dhe studentët
- Invalidët e luftës
- Rastet sociale (me librezë si dëshmi)
- Sëmundjet kronike dhe rastet terminale
- Vizitë e përsëritur
- Shërbime emergjente
- Personat e moshuar mbi 65 vjet
- Personat me aftësi të kufizuar

Për nxënës dhe raste sociale kërkohet Certifikata e gjendjes shëndetësore.



Harta do t'ju ndihmojë të dini saktësisht vend-ndodhjen e secilit institucion shëndetësor:

- Ngjyra e kuqe në hartë paraqet lokacionin e **Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare** në Lipjan.
- Ngjyra portokalli në hartë paraqet lokacionet e **Qendrave të Mjekësisë Familjare** në rrethinën e Lipjanit.
- Ngjyra gri në hartë paraqet **Ambulantat e Mjekësisë Familjare**.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan funksionin sipas orarit në vijim:

**SHËRBIMI
I URGJENCËS**

24 orë në ditë
/ 7 ditë në javë.

E Hënë – E Premte
07:00-20:00
E Shtune 07:00-19:00
E Diel 07:00-14:00



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ofron shërbimet në vijim:

- Vizitat mjekësore dhe mjekimin e pacientëve në bazë të nevojave të tyre (dhënien e terapisë me infuzione: injeksione, infuzione, shpërndarjen e barnave);
- Shërbimet diagnostikuese: Analizat laboratorike, Rëntgen, Mamografia, Ultrazëri (ECHO);
- Edukimin dhe promovimin shëndetësor: Këshillimin e pacientëve në Këshillimoren për edukim shëndetësor dhe këshillim motivues për sëmundjet kronike, shëndetin oral (kujdesin ndaj dhëmbëve dhe gojës dhe mjekimin), imunizimin (vaksinimin), këshillimin për adoleshentët dhe planifikimin familjar;
- Zbulimin e hershëm të shtatzënisë, kujdesin gjatë shtatzënisë, kujdesin pas lindjes dhe planifikimin familjar;
- Përcjelljen sistematike e të porsalindurve;
- Mbikëqyrjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve;
- Kujdesin për adoleshentë;
- Kujdesin për të moshuarit;

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ofron shërbimet në vijim:

- Kujdesin e vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo ngjitëse;
- Kujdesin emergjent dhe për lëndimet e vogla, shërbimet emergjente;
- Vaksinimet dhe dhënia e injeksioneve;
- Parandalimin dhe trajtimin e problemeve të zakonshme dentale;
- Kujdesin mjekësor në shtëpi: vizitat në shtëpi në rastet emergjente, vizitat në shtëpi për nënat dhe fëmijët deri në tre vjeç dhe trajtimin e dhimbjes dhe përkujdesja;
- Sigurimin e shërbimeve ambulantore dhe ndihmën mjekësore në kohën e duhur, nëse është e nevojshme, në vendet e grumbullimit në masë kur mbahen ngjarje sportive dhe kulturore



Qendrat e Mjekësisë Familjare në lokacionet më poshtë, kanë orarin si vijon:

MAGURE

E Hëne - E Premte: 08:00-20:00
E Shtune: 08:00-14:00
E Diele: 08:00-14:00

SHALË

E Hëne - E Premte: 08:00-20:00
E Shtune: 08:00-14:00
E Diele: 08:00-14:00

GADIME

E Hëne - E Premte: 08:00-20:00
E Shtune: 08:00-14:00
E Diele: 08:00-14:00

JANJEVË

E Hëne - E Premte: 08:00-20:00
E Shtune: 08:00-14:00
E Diele: 08:00-14:00

Të Dielën në Qendrat e Mjekësisë Familjare mund të drejtoheni te - Infermierët.

dhe kryejnë këto shërbime:

- Vizitat mjekësore
- Shërbimet laboratorike
- Shpërndarjen e barnave
- Edukimin dhe promovimin shëndetësor
- Shërbime stomatologjike

Ambulantat e Mjekësisë Familjare në lokacionet më poshtë, kanë orarin si vijon:

SLLOVI

E Hëne - E Premte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

SMALLUSHE

E Martë dhe e Enjte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

BABUSH

E Hëne - E Premte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

BANULLE

E Mërkure dhe e Premte:
08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

RUBOFC

E Hëne - E Premte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

KRAISHTË

E Hëne - E Premte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

DOBRAJE

E Hëne - E Premte: 08:00-15:00
E Shtune: 08:00-15:00

dhe kryejnë këto shërbime:

- Vizitat mjekësore
- Terapia parenterale: injeksione, infuzione
- Shpërndarjen e barnave
- Edukimin dhe promovimin shëndetësor

TË DREJTAT E PACIENTIT

Si pacient ju keni TË DREJTË:

Të keni qasje në shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta

T'i shmangeni dhimbjeve dhe vuajtjeve të panevojshme sa më shumë që të jetë e mundur në afat sa më të shkurtër kohor pa asnjë lloj diskriminimi..

Të informoheni saktë

Ju keni të drejtë të informoheni për gjendjen tuaj shëndetësore, shërbimet shëndetësore dhe si t'i përdorni ato.

Të jipni pëlqimin tuaj

Çdo procedurë e trajtimit mjekësor, duke përjashtuar rastet emergjente, do të bëhet me pranimin tuaj.

Të zgjidhni mjekun tuaj familjar

Ju keni të drejtë të zgjidhni mjekun tuaj familjar, nga i cili do të trajtoheni dhe këshilloheni.

Në konfidencialitet

Pacientët kanë të drejtë për mjekim personal, bazuar në nevojat e tyre, duke ruajtur privatësinë e informacioneve të lidhura me shëndetin, si dhe të procedurave të tjera diagnostikuese dhe terapeutike.

PËRGJEGJËSITË E PACIENTIT

Si pacient ju keni këto PËRGJEGJËSI:

Të keni dokumentin e identifikimit me vete

Merrni dokumentet personale të identifikimit me ju në çdo vizitë, në mënyrë që të jeni në gjendje t'i bëni kontrollet mjekësore.

Të trajtoni të tjerët me respekt

Respektoni rregullat operacionale të institucionit dhe bashkëpunoni me stafin shëndetësor pa ndërhyrë në të drejtat e tyre dhe të pacientëve të tjerë.

Të jeni të hapur me ofruesin tuaj të kujdesit shëndetësor

Jepni informata të plota dhe të sakta për sëmundjen ose problemin tuaj, sëmundjet e kaluara dhe medikamentet, për të mundësuar vlerësimin dhe mjekimin e duhur.

Të ndiqni planin tuaj të mjekimit

Ndiqni udhëzimet e dhëna nga stafi i kujdesit shëndetësor;

Të raportoni sëmundjet e transmetueshme

Raportoni një sëmundje që mund të rrezikojë shëndetin e qytetarëve të tjerë; dhe

Të kryeni bashkë-pagesën

Kryeni pagesat e kërkuara nga institucioni shëndetësor.

NE JEMI TË INTERESUAR T'I DËGJOJMË MENDIMET DHE SUGJERIMET TUAJA SI PACIENTË

Nëse keni ndonjë sugjerim për kujdesin që keni marrë, ju lutemi bisedoni për këtë me personelin në qendrën shëndetësore.

Përndryshe, mund të leni shënim në Kutinë e Ankesave që gjindet në institucionin shëndetësor, apo në Drejtoratin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Ministrinë e Shëndetësisë përmes linjës telefonike falas për ankesat e pacientit, në numrin: 0800 1 7777, ose përmes adresës elektronike: **linjafalas@rks-gov.net**

